



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.11.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun,

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

**R E N D D I T E**

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës nga DEFZH-ja, për aprovimin e vendimit për tatimin në pronë për vitin 2024
4. Shqyrtimi i kërkesës nga DKRS-ja, për dhënien në debat publik të Draft Statutit të Bibliotekës Komonale të Qytetit
5. Shqyrtimi i kërkesës nga DKA-ja. për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore
6. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-Vendimit nr.-II-1654, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Llazarevë, Milloshevë
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-Vendimit nr.-II- 1655, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Milloshevë dhe Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të prabishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 21 vota për.

**Pika e 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja**– Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DEFZH-ja, për aprovimin e vendimit për tatimin në pronë për vitin 2024.

**Enver Gashi** – Ne edhe në KPF, e kemi diskutuar këtë temë dhe jemi dakord që ky vendim të aprovohet. Është në të mirën e qytetarëve sepse zvoglohet tatami.

**Sami Ahmeti** – Realisht pas ndryshimit ligjor që është bërë, këto normat tatimore ashtu siç i biseduam edhe në KPF, janë minimale çka janë të mirëpritura për ne dhe për qytetarët e Obiliqit, kështu që si rrjedhojë do ta votojmë këtë propozim.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024.

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DKRS-ja, për dhënien në debat publik të Draft Statutit të Bibliotekës komunale të qytetit.

**Enver Gashi** – Ne si grup parlamentar jemi që ky Draft Statut të dalë në debat publik dhe sigurisht se si anëtarë të Kuvendit, do ta japim kontributin tonë kur të vjen në Kuvend dhe do ta bëjmë këtë Statut të Bibliotekës si është më së miri.

**Sami Ahmeti** – Ne e kemi lexuar kërkesën, por gjithashtu edhe Draft Statutin dhe duke qenë se është për me dalë në debat publik si gjithnjë jemi pro pastaj, shpresojmë se do të kemi mundësinë me dhënë kontributin tonë.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Statutit të Bibliotekës komunale të qytetit.

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DKA-ja, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

**Shaip Paloja** – Meqenëse, debati publik është një normë ligjore edhe grupi ynë është pro daljes në dëgjim publik të kësaj Draft Rregulloreje.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi pro daljes në debat publik të kësaj Draft Rregulloreje.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 20 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

**Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës të Kuvendit Komunal, ju duhet ti jepni propozimet.

**Labinot Mirena** – Propozon z.Enver Gashi, anëtar të Komisionit.

**Sami Ahmeti** – Duke qenë se vjet kemi pasë një përvojë të mirë unë propozoj veten time z.Sami Ahmeti anëtar të këtij Komisioni.

**Bajram Hashani** – Gjithashtu, edhe unë propozoj veten z.Bajram Hashani për anëtar të Komisionit.

Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për e formuan Komisionin për hartimin e Planit të Punës të Kuvendit Komunal me këtë përbërje:1.Enver Gashi, Kryetar, 2. Sami Ahmeti, anëtar dhe 3.Bajram Hashani, anëtar.

**Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për Propozim-vendimin nr.-II-1654, të dt.20.11.2023, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për z.k. Lazarevë, Milloshevë.

**Enver Gashi** – Së pari drejtori duhet me na dhënë sqarim pastaj Kuvendi e voton.

**Arben Berisha** – Ne i referohemi marrëveshjes së nënshkruar ditë më heret që e kemi mandamentue këtu dhe ju e keni votuar. Në marrëveshje janë të specifikuara edhe kërkesat tona që Komuna e Prishtinës, ka me i përmbushë obligimet që i ka ndaj marrëveshjes, për me i inicu procedurat e shpronësimit të këtyre parcelave të menaxhuara nga AKP-ja, dhe duhet ti shpallim zona me interes të përgjithshëm, që të futet në procesin e shpronësimit, që edhe çështjen e pagesës do ta bën Komuna e Prishtinës. Zonat kadastrale i kemi evidentuar të gjitha, përveç një që e kemi në Lazarevë dhe Milloshevë. Unë kam thënë edhe atëherë se është njëra prej marrëveshjeve më të mira të mundshme, që i referohemi dhe që është nënshkruar ndonjëherë në Komunën e Obiliqit, që banorët dhe Komuna e Obiliqit përfiton jashtëzakonisht shumë në kuadër të kësaj marrëveshjeje që ka ndodhë me Kryetarin e Komunës, dhe me Kryetarin e kryeqytetit.

**Enver Gashi** – Ne jemi për aprovimin e vendimit për shpalljen me interes të zonave, por procedura e votimit si është dhe a kemi ndonjë sugjerim nga Ministria.

**Kryesuesja** – Sqaron se votohen një nga një sepse janë parcela të ndryshme me të njejtin vendim.

**Sami Ahmeti** – Tash, ne po bëjmë fjalë për 2 kërkesa, kërkesa nr.1 dhe 2 që mundemi me konsiderue, njëra që ka të bëjë me bë shpronësimit ose me i bë me interes të veçantë zonat të cilat për shkak që e keni bë një marrëveshje të bashkëpunimit në korrik. Ndërsa, kjo marrëveshje e bashkëpunimit edhe pse ka pasë të bëjë me prona komunale, nuk na është ofruar në Kuvend. Sido që të jetë flitet për 546,561 m<sup>2</sup> ose thënë më ndryshe për 54 ha e 65 ari, e 61 metër. Në dokumente ceket se janë prona të KEK-ut, dhe tani cila është vlera e tyre dhe kush do ti kompensoj ato prona që kthehen nga pronat e KEK-ut, në prona komunale. Në ndërkohë që projekti i investitorit është komplet 17,000 m<sup>2</sup> ose 1 ha e 70 ari dhe pse i jepen dikujt 55 ha tokë, që sipas një hulumtimi bash kjo organizatë më shumë merret me prona e stoqe, e jo me ndonjëfarë investimi që i bjen diçka të mirë Obiliqit. Si rrjedhojë e kësaj, po delë që kur është fjala te pronat, ne nuk e fshehim por jemi si zakonisht kundër sepse konsiderojmë dhe kemi prova që zakonisht pronat keqpërdoren për mos me thënë më ndryshe gllabërohen për vete e zyrtarët. Prandaj, edhe për kërkesën e parë edhe për kërkesën e dytë jemi kundër dhe do ti ushtrojmë të gjitha kompetencat tona në të gjitha organet, që këto me i pengue.

**Kryetari** – Meqë, janë 2 pika të rendit të ditës po mundohem të japë përgjegje për të dyjat. E para, nënkupton një marrëveshje që është nënshkruar me Prishtinën, që kjo është në favor të Komunës tonë dhe të kompensohet ajo hapësirë që ka qenë e Ministrisë dhe nuk ka qenë në menaxhim të Komunës tonë. Mirëpo, meqë është në territor të Komunës, ne kemi kërkuar që ajo të kompensohet prej Prishtinës, dhe kemi arritë një marrëveshje përveç pikave tjera që janë në marrëveshje. Ndërsa, pika e dytë ka të bëjë me një kompani e cila merret me zona industriale, vie nga Britania e madhe që në këtë rast ne kemi negocu edhe me përfaqësues të ambasadës, ka qenë zëvendës ambasadori dhe ka qenë edhe përfaqësuesi i zhvillimit ekonomik. Ne jemi në fazën e parë, prona është e KEK-ut, ku pronar i pronave të KEK-ut është vetë Qeveria dhe ne kemi pasë raste kur kemi shpallë zona me interes publik në Komunën tonë, që kanë qenë parcela të KEK-ut dhe është vendim i drejtëpërdrejtë i Qeverisë. Ne e kemi njoftuar edhe Qeverinë për këtë veprim dhe me vazhdue me procedurën tonë të parë, e shpallim zonë me interes publik, pastaj nëse Qeveria e shehë të arsyeshme, unë besoj të bartet në pronësi të Komunës dhe të fillojnë negociatat për zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme.

**Kryesuesja** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, vendimi nr.1654, ka të bëjë me marrëveshje bashkëpunimi, realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projekteve për ngrohje diellore “Solar4Kosovo”. Ligjshmëria e këtij vendimi ka ardhë prandaj ky vendim është si rrjedhojë e kësaj marrëveshjeje.

**Ajet Berisha** – Në mbledhjen e kaluar veç e votuam memorandumin me Komunën e Prishtinës dhe elementi i shpronësimit nuk më duket se e kam pa që ka qenë në memorandum. Sido që të jetë unë prapë

e shohë interes në rast se e merrë përsipër vlerën e shpronësimit një Komunë tjetër, e që neve nuk na kushton. Unë veç po dyshoj te procedurat ligjore që jemi duke i marrë, a do të vlejnjë, apo jo sepse këtu bëhet fjalë për një pronë që është në menaxhim të AKP-së. Po ashtu, unë nuk e di a e dijmë investitori “Solar4Kosovo” kush është dhe a ka konkurrencë, do të thotë krejtë elementi i kësaj është që vendimet kur të merren me qenë në harmoni me mundësinë për të gjithë, e jo me iu trasue rruga dikujt që nesër mund të konsiderohet një lloj vendimi i institucionit për dikend që nuk iu ka dhënë mundësi të tjerëve, me ofrue atë shërbim psh ngrohje solare, apo çfarëdo qoftë ajo. Duke mos e kuptuar deri në fund këtë dhe duke mos qenë i sigurtë se ky vendimi ynë ka me ndikue që kjo pronë me u kthye se interes për Komunën e shohë, unë abstenoj. Pra, duke mos qenë tërësisht i qartë me procedurat dhe duke mos qenë i sigurtë se krejtë kjo është në harmoni me ligjet përndryshe do të isha për, por duke mos qenë krejtë i sqaruar mendoj se do të abstenoj, kaq e thjeshtë është.

**Kryetari** – Mendoj se e keni të qartë se bëhet fjalë për marrëveshjen me Komunën e Prishtinës. Komuna e Prishtinës bashkërisht me MMPHI-në, e ka zhvilluar një projekt me Komunën tonë, që siç e dijmë ne është pronë e Ministrisë. Mirëpo, meqë është futë në territorin e Komunës dhe LVL-ja, na e lejon këtë të drejtë ne kemi kërkuar që të na kompensohet ajo hapësirë pavarësisht që nuk është pronë e jona. Ne tekstualisht e kemi thënë edhe në Ministri, por ja ne po dojmë me shpallë zonë me interes publik dhe po dojmë me ble. Përfundimisht kemi arritë te një marrëveshje që në pjesë, apo hapësirë të asaj zone të na kompensohet nga Komuna e Prishtinës. Jemi dakorduar 2 Komunat që e kemi nënshkruar marrëveshjen dhe potencohet se ne e shpallim zonë me interes publik, pastaj vlerën e përcakton Ministria, në këtë rast Komisioni nga Departamenti i financave që merret me vlerësimin e pronave dhe atë pronë sado që kushton barrë do ta ketë Prishtina me pague, e jo ne. Kjo, është një diçka jashtëzakonisht e mirë për Komunën tonë sepse ne në mungesë të hapësirave, pronave që i kemi, e kemi një mundësi shumë potenciale që ti marrim shumë hektarë në këtë rast në këmbim të asaj që ka ndodhë në territorin e Komunës tonë me “Solar4”.

**Ajet Berisha** – Tash është e qartë, që mendoj se është interes dhe ne në këtë rrethanë e votojmë kërkesën e parë.

**Kryesuesja** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, shkojmë me votimin e parcelave një nga një. E kemi Propozim-vendimin nr.-II-1654, të dt.20.11.2023, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik në njësitë kadastrale në zonën kadastrale Llazarevë dhe Milloshevë. Të miratohet ky Propozim-vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për njësitë kadastrale si në vijim:

P-72614041-00024-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës, Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa:Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5, me sipërfaqe prej 7353 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQESIA; Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00024-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa:Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 4552 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00025-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa:Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 5517 m<sup>2</sup> Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00025-2, Tipi i pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa:Bujqësore - Arat-Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 2600 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00025-3, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R/Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 1187 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P- 72614041-00025-4, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa; Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 2931 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041 - 00026-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R: Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 10890 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë: vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00026-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R: Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 3996 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë: vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00027-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R: Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5: me sipërfaqe prej 15431 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë: vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT –N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00027-2 Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private /R: Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 1726 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.Bujqesia;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00028-0, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R: Shfrytëzim aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 19022 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00031-0, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 4 me sipërfaqe prej 13884 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00032-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 37414 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.  
**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00032-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 22218

m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00033-0, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 30795 m<sup>2</sup> Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT- N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00034-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R;Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa:Bujqësore-Arat-Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 20000 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT –N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00035-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 36096 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Hapur e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT- N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00035-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 4 me sipërfaqe prej 10155 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Hapur e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT –N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614041-00036-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R;Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa:Bujqësore-Arat-Arë e klasës 3; me sipërfaqe prej 5994 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur Tërshevina te Llazareva e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela e radhës është P-72614041-00036-2. Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa: Bujqësore-Arat-Arë e klasës 3 me sipërfaqe prej 5300 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina te Llazareva e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT-N.SH.BUJQESIA;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** - Parcela tjetër është P-72614051-00226-0, Zona:Rural; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi aktual i parcelës:Arat;Kualiteti i klasës: Arë e klasës 6; me sipërfaqe prej 120229 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1; Vendi i quajtur: Jezero; zk..Milloshevë e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQESIA.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 6 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Të nderuar. Anëtarë të Kuvendit Komunal Aprovohet Vendimi nr.-II-1654, i dt.20.11.2023, Propozim-vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për njësitë kadastrale në zonën kadastrale Llazarevë dhe Milloshevë.

#### **Pika 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Propozim-Vendimit nr.-II- 1655, të dt.20.11.2023 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për zk.Milloshevë dhe Obiliq.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që edhe ky Propozim-vendim të aprovohet dhe të shkohet një nga një.

**Sami Ahmeti** – Për mos me u përsëritë sepse unë i përshkrupa të dyja së bashku. Kjo, e para që u trajtue ka dallim për faktin se bëhen prona të Komunës, ndërsa kjo e dyta është tendenca e pronave që janë të KEK-ut, të bëhen një herë të Komunës, por të kalojnë te kjo organizata britanike me qendër në Londër. Tash, pyetja konkrete është 54 ha e 65 ari e 61 m<sup>2</sup> qka i duhen një ndërmarrjeje të tillë për investim në

projektit e tyre, që e kanë bërë një projekt me gjithsejt 17000 m<sup>2</sup>. Kjo është pyetja jonë, në ndërkohë mund të kyqemi përsëri.

**Ajet Berisha** – Unë kur thashë për paqartësi, pothuajse është e megjulluar tërësisht. E para, në çfarë mënyre pretendojmë ne me dhënë, në këtë e shpallim zonë me interes të veçantë dhe pretendojmë me ia dhënë një kompanie, që e eliminojmë tërësisht konkurrencën. E dyta, mendoj se kjo do të hasë në pengesa të shumta ligjore dhe do të kthehet ky vendim edhe për një arsye. Në rast se ky është investitor i madh është dashtë me cekë se kjo shkon në bazë të ligjeve për investime strategjike, apo diçka tjetër. Këtu, nuk kemi shpjegime, Komuna ka marrë përsipër në një memorandum me ia gjetë parcelat kësaj kompanie dhe kjo kompani nuk merrë përsipër në këtë memorandum bash kurgjë. Këtu, përmenden 100 punëtorë, por shihni në fund thotë se ky memorandum vlen derisa të kryhet investimi dhe më nuk është i detyrueshëm askush me zbatue këtë marrëveshje të memorandumit. Në rast se është kështu, pse Komuna duhet me marrë përsipër një angazhim të tillë që me ia gjetë parcelat, me i bë të gjitha këto rrugë ligjore që prapë kanë me qenë problem për me i realizue, me ia dhënë dikujt që ti paraprakisht po e din, që edhe me negocijim është problematike sepse prapë duhet me dhënë në konkurrencë. Në rast se është me investime strategjike sipas Ligjit për investimet strategjike, mendoj se është rrugë e gabuar sepse kjo shkon përmes Ministrisë, kështu që krejtë kjo është një veprim që po e bëjmë, që në fund delë se Ministria na e kthen se vendimi është i paligjshëm, nuk është në kompetencën, as të drejtën e juaj. Mirëpo, prapë është një konflikt interesi në kuptimin që e eliminojmë konkurrencën në tërësi. Ne mbi 50 ha po dojmë me ia dhënë një kompanie pa i futë në konkurrencë, që dikush tjetër për ata 54 ha kishte mund me ofruë më shumë. Ligjet janë të qarta, në rast se te ajo patëm shpjegime se Komuna nuk merrë obligime, Prishtina i bën investimet është marrëveshje me Ministrinë për rrugën qysh me ndjekë dhe përfitojmë ne, ajo është e pastërt. Në rast se keni bërë gabime prapë do të kthehet, ndërsa te kjo është komplet e kundërta dhe është komplet megjull, eliminohet konkurrenca, nuk është në kompetencën tonë dhe prapë kemi me u anulue për shkak të konkurrencës sepse duhet me shpallë. Mirëpo, edhe memorandum është i pakuptimtë sepse askush nuk merrë përsipër se ne e kemi inicue por ai në fund thotë se unë i kryva investimet, nuk marrë përsipër nga ky memorandum sepse e keni shkruar si pikë. Në memorandum thotë se këtu nuk është i detyrueshëm dhe ai i kryen investimet në rast se vjen por nuk vjen atje hiç.

**Arben Berisha** – Tani i kemi 2 tema, njëren veç e përfunduar, por tash jemi në rend dite se parafolësi z.Sami tash je në rend dite se më heret ishe jashtë rendit të ditës sepse po e shikon KTV-në dhe po e humbë rendin e ditës. Tash, qytetarët le ta dijnë dhe kuptojnë situatën qysh është, e jo megjullnajë. Marrëveshja ka qenë memorandum me Komunën e Prishtinës, krejtë shpenzimet i bartë Prishtina dhe prapë je kundër. Edhe parcela që e ka marrë Komuna e Prishtinës për ngrohje solare ka qenë e Qeverisë, e jo e jona dhe ne kemi negociju, Kryetari ka mbërri me futë Prishtinën në obligime që me i bë pagesat për pjesën tjetër që ne veç e shpallëm. Tash, po flasim për pikën e rendit të ditës se jam ekonomist, e jo psikolog më fal kryesuese se kisha pasë dëshirë veç me ditë këta njerëz çka mendojnë, e jo veç negativ gjithë sepse nuk është edhe interesantë gjithë negativ. Këtu, po përfiton komuniteti banorët e Komunës së Obiliqit. Shpallja me interes të përgjithshëm nuk do të thotë se ne sot ia dhamë x kompanisë sepse ne po bëjmë shpallje me interes të përgjithshëm. Këtu, e kemi memorandumin që e ka nënshkruë Kryetari dhe nuk prodhon efekte juridike. Ndërsa ai atëherë ka prodhue efekte juridike që është dashtë me zbatue dhe Komuna e Prishtinës, e ka obligim me zbatue sepse e dërgojmë në Gjykatë. Ky nuk prodhon, por kontaktet që i kemi pasë besoj se i keni pa edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të Komunës me ambasadorin, me ministrat e linjës edhe me zyren e Kryeministrit dhe komplet vijën e kemi shterrë e kemi ardhë deri këtu. Është një investim strategjik, ligji e thotë mbi 10 milionë euro cilësohet si investitor strategjik që ka me iu nënshtruar kompetencave të Qeverisë, e jo neve. Mirëpo për me i ndjekë hapat sipas ligjit duhet të shpallet zonë me interes të përgjithshëm dhe ne këto i kemi praktika sepse ne kemi marrë tokë të KEK-ut edhe më heret në vitin 2014 ose 2015 që e kemi ndërtue sheshin. Tani, po i ushtrojmë praktikat prapë, po bëjmë zona zhvillimore, po mendojmë me zhvillue qytetin dhe a ka keqpërdorime apo nuk ka ne ballafaqohemi, e ti mos u merrë me këtë temë. Unë iu kam thënë edhe më heret lavdërone

edhe ju se ka ndodhë mrekulli dhe sot i ke të punësuar atje gati 1000 vetë. Ata që nuk investojnë ua marrim në seancat e radhës.

**Sami Ahmeti** – Unë jam në rend dite si zakonisht dhe nuk ka nevojë me dalë prej temës. Kryesuesja kur i bëri propozimet i ceku si dy tema dhe mendova që po i trajtojmë të dyja menjëherë, kështu që nëse është bërë pak më heret ose pak më vonë, nuk besoj që të ka djersit. Problemi është se ju e thatë se nuk themi ne që ka me marrë kjo ose ajo kompani, a ka mundësi të lutem me ma lexue nenin 2 të propozimit të Kryetarit për çka është qëllimi i shpronësimit, të lutem. Do të thotë se qëllimi i paraqitjes së këtij Propozim-vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të njërive kadastrale të cekura në nenin 1 është për kompaninë angleze Chayton Capital. Kështu, po thotë do të thotë qysh paraprakisht bëhet plani kanë me u bërë prona publike, pastaj kemi me ia dhënë këtij gjithçka me plan. Kjo është kontestuese tani ka tjera, por nuk dua të dalë jashtë teme edhe pse ti dole nuk është problem se e ke në fjalor tëndin.

**Arben Berisha** – Për këtë po iu them lexoni sepse ne i referohemi ligjeve.

**Sami Ahmeti** – Më ka çudit fakti që the jam ekonomist sepse unë kam mendue që as shkollën e mesme nuk e ke të kryer, beso në bazë të prononcimeve të tua, konsistencës tënde dhe shkrimeve tua. Mirëpo, më vjen mirë që AAB-ja, ta paska shitë edhe shumë bukur.

**Arben Berisha** – Edhe ti kishe dhënë mësim apo nuk e di qysh ka qenë puna, që të kanë largue. Neni 2 i Propozim-vendimit i referohet Udhëzimit administrative, neni 35 që thotë në bazë të rekomandimit aline 3 nga raporti i Kryetarit dhe këtu e kemi bërë një raport arsyeshmërinë pse po e shpallim zonë me interes të përgjithshëm. Thotë profesional të Kryetarit, prona e cila duhet të bartet në Komunë prej institucioneve qendrore në institucione lokale dhe duhet të shpallet nga Kuvendi i Komunës pronë me interes publik. Pastaj, në të ardhmen kërkohet me sjellë një projekt detaj dhe ka me iu nënshtruar sepse ky do të trajtohet si investitor strategjik. Ne nuk mund ta japim prapë edhe me dashtë sepse mbi 10 milionë ligji e thotë se duhet të iu nënshtruhet institucioneve qendrore.

**Ajet Berisha** – Në rast se investimi është strategjik përpara ka qenë te Ministria e industrisë dhe tregtisë, ajo është marrë ndërsa, tash nuk e di se nuk jam në ngjarje por është e rëndësishme direkt Qeveria. Në këtë rast pse po hyni në marrëveshje që mund të na i kthejnë neve pa ndonjë interes, por në rast se ka interes Qeveria që ky investitor me 200 milionë me ardhë ajo iu drejtohet juve me kërkesë. Ai bën kërkesë e thotë e kam pa një parcelë që mund të më delë në ndihmë Komuna e Obiliqit, që është krejtë në rregullë dhe Ministria ua bën kërkesën, thotë është investitori 200 milionë. Ju nuk thirreni në këtë memorandum që për mua është i kotë sepse nuk fitojmë kurgjë dhe nuk merrë obligime ligjore asnjëra palë. Ne po i nisim procedurat, po ia kryejmë punët dhe Ministria i merrë obligimet, duhet me i krye punët e veta për një diçka që prapë ai nuk merrë obligime që ne si Komunë fitojmë diçka. Unë u mendova me qenë krejtë i thjeshtë drejtor dhe në rast se më bind që kjo krejtë është ndryshe unë kërkoj falje, por nuk ka mundësi potenciale në rast se investitori është strategjik që ne me nisë procedurën. Ministria e nisë procedurën ndërsa, ne i kryejmë obligimet tona, kur Ministria na thotë ky është obligim i juaji që në këtë hapësirë ky ka parë interes me investue e tash ju merrni hapat e juaj. Përndryshe, vërtetë të gjitha këto janë hapa të ngutshëm që neve kërkush nuk ka me na pyet për këtë punë. Unë mendoj kështu, edhe shpjegimet nuk po dalin tash në rast se është në bazë të Ligjit për investime strategjike, ju në preambulë ku e keni shkruar këtu neni 12.1, LVL nuk përmendet ai ligj këtu. Andaj unë i kam dyshimet e mia sepse si investim e kam mendue se do të jetë investim strategjik i madh që i përfshin ligjet tjera, e jo përmes Ligjit të dhënies së pronës në shfrytëzim që nuk ka me u trajtue, andaj pse po thirremi në diçka që ky nuk ka me marrë këtë rrugë. Ky ka rrugë tjetër për me investue. Mendoj se këtu, e kam shumë të paqartë dhe këtu e tutje, Ministria ka me na kthye si diçka që nuk është në dorën tonë.

**Arben Berisha** – Çdo vendim që e merrni ne jemi për sqarime. Ne nuk kemi projekt detal nga kompania dhe kur na vjen projekti detal atëherë ai i nënshtruhet procedurave për marrjen në shfrytëzim të parcelës. Ne sot vetëm po e shpallim zonë me interes të përgjithshëm dhe absolut nuk po bëjmë kurgjë. Pastaj, kur vjen me projekt delë prapë këtu, do të bisedojmë dhe nëse është mbi 10 milionë euro, ligji e thotë se ne nuk mundemi me trajtue edhe me dashtë ne sepse i nënshtruhet institucioneve qendrore. Kompania me



ambasadën ka ardhë ka kërkuar dhe na ka lutë a keni pozicion të tillë në Obiliq sepse është vend strategjik për investim, por pronë tonën nuk kemi në këtë masë që ti e kërkon, por ne po të ofrojmë një mundësi përmes institucioneve qendrore, hajde e trajtojmë lëndën në këtë formë me shpallë zonë me interes të përgjithshëm, me bartë në emërt të Komunës, pastaj me iu nënshtruar procedurave për marrjen në shfrytëzim.

**Shaip Paloja** – Ne të gjithë jemi dëshmitarë se KEK-u, pronat e Komunës së Obiliqit mbi 70 % qysh prej viteve 60 i ka marrë. Është fat i mirë dhe shumë fat i madh nëse, ne arrijmë që ato pronat me i kthye në prona të Komunës së Obiliqit. Edhe atëherë kur janë marrë ekzistojnë edhe vendimet që pronat kur KEK-u, i merrë deri në momentin që nuk i shfrytëzon i kthehet pronarit. Në këtë rast është shumë e mirë edhe puna e Kryetarit dhe Drejtorisë përkatëse që bëjnë një angazhim që në Komunën tonë të sjellin shumë investitorë. Tash, pse e shpallim zonë me interes publik, ne e shpallim sepse është në territorin e Komunës së Obiliqit dhe nuk mundet me shpallë Drenasi, ne e kemi obligim me shpallë atë. Unë po e shohë se është një proces që nuk përfundon tash, por mund të zgjatë me vite e vite dhe a do të përfundoj në mandatin e z.Xhafer Gashi sigurisht se deri në vitin 2030 ka me përfundue. Prandaj, është shumë, shumë e mirëpritur investimi i këtij operatori apo të gjithë operatorëve tjerë.

**Kryesuesja** – Vazhdojmë me votim të Propozim-vendimit nr.-II-1655, të dt.20.11.2023, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për njësitë kadastrale në zonën kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq. Parcela me nr.72614055-00066-1, Lloji i Njesisë: Parcelë: Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Tokë Tjetër; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Jo pjellore; me sipërfaqe prej 136696 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq: vendi i quajtur “Aerodrom” e cila evidentohet në emër të KEK Sh.a.; Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për 4 vota kundër dhe 2 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela tjetër është P-72614055-00066-2, Lloji Njesisë: Parcelë: Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të Parcelës: Tokë Tjetër ; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Jo pjellore; me sipërfaqe prej 1470 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq: vendi i quajtur “Aerodrom” e cila evidentohet në emër të KEK Sh.a.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për 4 vota kundër dhe 2 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Parcela e fundit është P-72614051-00836-3, Lloji i Njesisë: Parcelë: Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Kullosat; kualiteti i klasës: Kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 408395 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Milloshevë; vendi i quajtur: “Njive Kod Aerodr.” e cila evidentohet në emër të KEK Sh.a.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për 4 vota kundër dhe 2 vota abstenim e miratuan parcelën e cekur më lartë.

**Kryesuesja** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, aprovohet Vendimi me nr.-II-1655, i dt.20.11.2023, Propozim-Vendimi për shpallje me interes të përgjithshëm publik për njësitë kadastrale në zonën kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq.

Në sallën e Kuvendit gjithsejt janë 19 anëtarë prezentë ndërsa Linda Sadiku dhe Samire Berisha e kanë liruuar sallën.

#### **Pika 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-19 të dt.04.02.2022, të KKSB-së për zëvendësimin e z.Behar Mjekiqi me z.Agon Dragusha.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 3 vota abstenim morën Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-19, të dt.04.02.2022, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) duke zëvendësuar anëtarin nr.3 Behar Mjekiqi me z.Agon Dragusha.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Berat Mehmeti për blerjen e pajisjeve shtesë në shumën prej 30.000 euro për Ndërrmarjen Publike Lokale “Kastrioti” SH.A me qëllim të kryerjes së punëve me efikasitet në Komunën e Obiliqit.

**Enver Gashi** – Pasi që është drejtoresha këtu le të na sqaron prej cilës vijë buxhetore merren mjetet përndryshe jemi për ti ndihmuar kësaj kompanie.

**Sami Ahmeti** – Le të na tregoj fillimisht drejtoresha pastaj, e marrim fjalën.

**Zarife Behluli** – Sqaron se mjetet ndahen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHPE) në emër të subvencionimit.

**Ajet Berisha** – Pyeti se a kemi të drejtë të bëjmë një ndarje të tillë të mjeteve buxhetore.

**Zarife Behluli** – Përgjegjet po.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 15 vota për dhe 4 vota abstenim morën Vendim për aprovimin e kërkesës së Ndërmarrjes Publike Lokale Kastrioti SH.A. për blerjen e këtyre pajisjeve:

1.Snow Sweeper (pajisje e cila shërben për largimin e borës nga hapësirat publike).

2.Multitrimmer Timan (pajisje e cila shërben për prerjen e degëve të ndryshme përgjatë rrugëve të Komunës së Obiliqit).

3.Weed Brush (pajisje e cila shërben për largimin e barishteve të ndryshme për hapësirat publike).

### **Pika 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit për plotësimin dhe ndryshimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit. Kjo Drejtori ka harmonizuar Planin me plotësim ndryshim dhe ka marrë aprovimin nga MMPHI-ja, me dt.20.11.2023.

**Enver Gashi** – Ne jemi për plotësim ndryshimin e këtij Plani.

**Sami Ahmeti** – Naryrisht që jemi pasi që Ministria e ka kthye se ashtu duhet të jetë, ne jemi në rregullë dhe jemi pro.

**Xhelal Krasniqi** – Realisht një raport i publikuar nga një organizatë vendore dhe ambasada suedeze kanë ngritë alarmin për ndotjen që e bën Kosova B me 8354 tonë pluhur të sulfurit nga të dy blloqet. Ne jemi të vetëdijshëm se edhe në shtetet më të zhvilluara në fillimet e tyre kur kanë qenë në pyetje interesat madhore shtetëore siç është te ne punësimi kanë bërë kompromis me ambiente, por asesi pafundësisht. Është çështje e ndjeshme dhe ne bashkëndejmë me ata sa i përket vendeve të punës, por nëse i kthehemi historisë së Termocentraleve Kosova A dhe Kosova B delë se Kosova A është ndërtuar në vitin 1962 ndërsa Kosova B në vitin 1983. Pra, edhe njëherë të dy blloqet e Kosovës B bëjnë ndotjen më të madhe për periudhën e njejtë kohore se sa dy blloqet e Kosovës A. Në këtë rast më vjen mirë për këtë iniciativë, për këtë ide për këtë plotësim ndryshim që nga Ministria e Ambientit të angazhojnë më shumë inspektorë që të monitorojnë tymtarët me theks të veçantë të Kosovës B. Nëse, një Termocentral si Kosova A që është ndërtuar 21 vjet, më heret kanë arritë me rregullue ose gjenerue me monitorue ndotjen e ambientit atëherë pse mos me bë menaxhmenti i KEK-ut edhe me Kosovën B.

**Enver Gashi** – Për hir të profesionalizmit të ndotësve kryesor që i kemi në Kosovën B, kam qenë deri vonë aty një prej akterëve kryesor dhe mund të them se filtrat në Kosovën A nuk është moti i ka dikund 7,8 ose 10 vjet që janë ndërrue dhe ata kanë një garancion dikund 25 – 30 vjet. Filtrat në Kosovën B janë ndërtue qysh në fillim kur është ndërtue Kosova B, në vitin 83 ose 84 që janë lëshue në prodhim. Është një investim më shumë premtim i bashkësisë evropiane ndërkombëtare që të investojnë në filtrat e Kosovës B, por ngjarjet që ndodhën covidi, lufta në Ukrainë, u çrregulluan pak marrëdhëniet dhe buxheti po ashtu kështu që kjo është që ka ngecë. Ne mbetemi me shpresë që edhe Qeveria edhe menaxhmenti i KEK-ut dhe bashkësia evropiane do të gjejnë një gjuhë sa më të përbashkët që të kryhet investimi i filtrave të Kosovës B.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për e aprovuan Vendimin për Plotësim Ndryshimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit.

**Kryesuesja** – Ju e dini se kemi marrë vendim për e faljen e tatimit në pronë sipas të cilit lejohet shuma e faljes së tatimit në pronë, për të gjithë tatimpaguesit deri në lartësinë e fakturës së tatimit në pronë për vitin 2023 por jo më shumë se 100 euro. Po ashtu, iu kam njoftuar edhe me shkresën nga Ministria e financave, ku kanë kërkuar se vendimi nuk mund të ekzekutohet deri në momentin e largimit të pezullimit nga Gjykata. Ne nuk e kemi ekzekutue vendimin, por kemi thënë se deri me dt.30.11. që i bjen sot po presim përgjegje ose vendim përfundimtar nga Gjykata, pastaj veprojmë. Dje kam kontaktue me

Ministrinë e financave dhe zyrtarja ligjore më ka thënë se nuk ka nevojë të merret vendim mbi vendim sepse ne nuk e kemi shfuqizue dhe vendimi prodhon efekt juridik. Po ashtu, deri të hënën pritet konfirmimi i ligjshmërisë nga Ministria e financave, në mënyrë që Drejtoria e financave të filloj zbatimin e këtij vendimi menjëherë.

**Sami Ahmeti** – Ne tashmë kemi marrë vendim dhe nëse, edhe nuk kthehet ligjshmëria deri të hënën nuk do të thotë se e shfuqizon vendimin paraprak sepse vendimi i Gjykatës kushtetuese e thotë se kanë mbetë sa e di unë edhe 15 ditë deri në nxjerrjen e vendimeve.

**Kryesuesja** – Nga 24.11. është afati deri me 8 dhjetor.

**Sami Ahmeti** - Ato Komuna, që tashmë kanë nxjerrë vendim edhe nëse vonohet deri me atë datë kthimi i ligjshmërisë konsiderohet si vendim i mirëqenë dhe mund të ekzekutohet.

**Xhelal Krasniqi** – Realisht çështja ka të bëjë me planifikimin buxhetor në nivel të vendit ku është bërë leximi i parë në Parlamentin e Kosovës. Pra vitin e kaluar siç e dini kemi qenë të penalizuar ku në mesin e 18 Komunave shqiptare ne nuk kemi pasë asnjë planifikim për investime të reja në Komunën tonë. Nga ajo që kemi parë dhe dëgjuar sidomos nga drejtori i Asociacionit të Komunave z.Sazan Ibrahimimi me buxhetin e vitit 2024 në 22 Komuna shqiptare nuk ka ndarë buxhet për projekte të reja. Unë në këtë rast shprehu shqetësimin tim që sigurisht edhe Komuna e Obiliqit, do ta ketë fatin e njëjtë të vitit të kaluar. Singërisht kërkoj nga anëtarët e Kuvendit partia e të cilëve udhëheqë me Qeverinë e vendit të shfrytëzojnë autoritetin e tyre, ose përmes deputetit që vjen nga Obiliqi, ose ndonjë modalitet tjetër me të vetmin qëllim që qytetarët e Obiliqit, të mos mbeten edhe këtë vit pa investime të reja kapitale në Komunën tonë.

**Sami Ahmeti** – E mirëpres çdo kërkesë që është konkrete për dallim prej vitit të kaluar që besoj se jemi shpjegue, duhet të bëhen kërkesa dhe duhet të dimë edhe ne se çka vërtetë po kërkohet sepse sa jam i informuar buxheti në lexim të dytë do të votohet me datën 14 dhjetor. Mundësitë tashmë janë shumë të vogla sepse kanë hy ato kornizat përfundimtare, por deri në këtë moment nuk kemi asnjë kërkesë apo indikacion të ndonjë nevojë që ka planifikue Ekzekutivi, përveç asaj që Ministria e Arsimit ka marrë obligim ndërtimin e

çerdhes në Milloshevë, që përveç asaj ka edhe zotim të hapur ndërtimin edhe të një çerdheje tjetër. Në takimin që e kemi pasë në përrurimin e fillimit të

çerdhes në Milloshevë, vetë ministresha i ka kërkuar Kryetarit gjene hapësirën ne jemi të gatshëm ta ndërtojmë edhe një çerdhe tjetër. Gjithmonë ka mundësi kur ka kërkesa konkrete, por jo në momentet e fundit sepse e keni parasysh buxheti është i krenjtë Kosovës dhe nuk është i një Komune, që me mund me bë akrobacione.

**Shaip Paloja** – Unë kam vetëm një pyetje për kolegun Sami, këta janë banorë të Obiliqit dhe e përfaqësojnë komunitetin, qytetarin e Obiliqit cilat janë kërkesat e tyre që ia kanë bë Qeverisë për Komunën e Obiliqit.

**Sami Ahmeti** – Nuk i përgjegjem kësaj pyetjeje.

**Arben Berisha** - Një reagim se nuk mundemi me tejkalue për arsye se nuk është e vërtetë që Ministria, i ka përfshi çerdhet në buxhetim, por kërkesa ka qenë e mëhershme në mënyrën procedurale prej Kryetarit. Edhe ministresha vetë e potencon që është Komuna e parë që e ka sjellë kërkesën dhe komplet dokumentacionin e mundshëm. Ne i kemi parapri çështjes dhe Qeveria është e jona, nuk është e Ahmetit, as e tjetrit, as e atij tjetrit dhe lëre që nuk i kanë përkrahë projektet e Komunës së Obiliqit, por këta e kanë pengue dhe nuk e kanë votue. Prandaj, secili le të mbetet në ndërgjegjen e vetë, por qytetarët e dinë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:28'

Bashk.prof. për punë të KK

  
Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal

  
Vlora Mjekiqi Kabashi